

KONVENTA PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Sesioni I, Grupi i Punës I (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore)

Tema: Sistemi i Drejtësisë për të Miturit

16 korrik 2015

Zhvillimet aktuale

Tema të ndjeshme si Sistemi i drejtësisë për të miturit shpesh harrohen në debatet e mëdha ku flitet për reformën në drejtësi, hapjen e negociatave etj. Rastet e fundit problematike të cilat kanë nxitur debatin publik japin një mesazh të fortë dhe kujtesë për fokusin që i duhet kushtuar sistemit të drejtësisë për të miturit

Në kuadër të sistemit të drejtësisë për fëmijët, duke patur parasysh nenin 54 të Kushtetutës të Shqipërisë, që parashikon mbrojtje dhe përkrahje të veçantë nga shteti për fëmijët, vlerësohet si hap pozitiv hartimi i një **Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve**, konsultimet e të cilit fillojnë në shtator 2015.

Grupi i Punës vlerësoi si pozitive shtrirjen e **Shërbimit të Provës** në gjithë Shqipërinë- vendosur sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 100, datë 21 shkurt 2014. Në këtë mënyrë përmbushet objektivi për të pasur zyrë vendore pranë çdo rrethi gjyqësor në Shqipëri. Kështu përpos zyrave ekzistuese, ka filluar funksionimi dhe në zyrat vendore Tropojë, Pukë, Dibër, Kurbin, Krujë, Kavajë, Lushnjë, Pogradec, Përmet dhe Sarandë- në total 22 të tilla.

Me qëllim vlerësimin e strukturuar të të gjithë të dënuarve të mitur që bien në kontakt me sistemin e drejtësisë penale, analizimi i autorit të veprës penale dhe identifikimi i shkaqeve, në 2014 ka nisur implementimi i **Sistemit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë për të Miturit(SVRM)**. Sipas grupit të punës, ky instrument është i domosdoshëm në parashikimin dhe parandalimin e sjelljes kriminale duke rezultuar në rritjen e sigurisë në komunitet.

Një element tjetër pozitiv i evidentuar ishte dhe fillimi i një projekti pilot, puna e së cilit fokusohet në **ndërgjegjësimin dhe nxitjen e të rriturve**, më së shumti sipërmarrësve për të punësuar fëmijët e dënuar. Duke qenë një ide e zhvilluar vetëm

2 muajt e fundit, fakti i punësimit i 3 të miturve në këtë periudhë të shkurtër kohore u cilësua si një hap premtues për zgjerimin e kësaj iniciative.

Probleme & Rekomandime:

- Drejtësia për të mitur nuk duhet të kufizohet vetëm në të drejtën penale, pasi ajo është ndërlidhur me shumë fenomene çka nënkupton familjen, sistemin arsimor dhe mbrojtjen sociale. Kur i referohemi fëmijëve duhet patur parasysh që janë pjesë e një familjeje që ka detyrim ligjor për mirërritje dhe edukim, si dhe janë qytetarë të shtetit dhe duhet të përfitojnë edukim, informim dhe zhvillim të mjaftueshëm nga sistemi i edukimit. Fëmijët e akuzuar janë viktimë të mangësive të edukimit dhe kujdesit që prodhohen nga familja, shoqëria dhe shteti, prandaj nevojitet **forcimi i bashkëpunimit dhe mirëkoordinimit të këtyre institucioneve**.
- Po ashtu, në mënyrë që të mos lihet në hije aspekti social, sugjerohet bashkëpunim ndërsektorial mes **politikave sociale dhe sektorit të drejtësisë**
- Konstatohen raste të shumta ku ka mungesë të hetimit të plotë e të gjithëanshëm të shkaqeve dhe rrethanave që e çojnë të miturin në krim nga ana e organeve të drejtësisë, si dhe mungesë të kulturës së punës me fëmijët. Duhet një trajtim i veçantë i të miturit nga legjislacioni penal, norma të veçanta procedurale, që të përshtaten më mirë me nevojat e trajtimit të të pandehurit të mitur, masa sigurimi më të përshtatshme për ta, afate kohore më të reduktuara për hetimin e gjykimin e tyre. U sugjerua ngritja e një **Gjykate për të Miturit**, duke specializuar një grup të kualifikuar gjykatësish dhe prokurorësh për trajtimin e të miturve.
- Sipas statistikave, rezulton që 90% e fëmijëve që marrin një dënim penal bëhen **recidivist**, kthehen prapë në burg. Nevojitet një forcim i **Programit të Riintegritit të fëmijëve**, i cili përfshin aktivitete argëtuese si dhe punë të konsideruara nga grupi i punës si të pamjaftueshme. Duhet bërë më shumë punë edukuese dhe shumëllojshmëri aktiviteteve gjatë kohës që kryejnë dënimin si të mitur.
- Kryesisht veprat e kryera nga të miturit janë vjedhje, por vitet e fundit kostatohet përfshirja e të miturve në vepra penale të rënda, si plagosjet, vrasjet, tregtimi i lëndëve narkotike etj. Shihen si të domosdoshme realizimi i **analizave që trajtojnë fenomenet në mënyrë ndërdisiplinore për**

të kuptuar cilat janë shkaqet dhe për të përcaktuar rrugët për përmirësimin e situatës.

- Pavarësisht rolit pozitiv të ngritjes së Institutit të veçantë për të Miturit, konstatohen **raste që në Paraburgim, të miturit qëndrojnë bashkë me të rriturit**. Po ashtu, femrat e mitura marrin një trajtim të njëjtë me të burgosurit meshkuj. Kjo situatë duhet të adresohet me përparësi pasi është në kundërshtim me ligjin, dëmton interesat e të miturve dhe krijon kushte për manipulimin e tyre nga keqbërësit e rritur.
- Sipas rasteve të identifikuara, ka një mungesë psikologësh e sociologësh të specializuar për të punuar që merren posaçërisht me fëmijët e dënuar. Psikologët janë me profil të përgjithshëm dhe intervistat e tyre nuk trajtojnë nevojat specifike të fëmijëve. Duhet të ngrihen **ekipe ndërsektoriale dhe ndërdisiplinore të specializuar për fëmijët**, ku të bashkëpunojnë dhe koordinohen ekspertëtë disiplinave të ndryshme si sociologë, psikologë, gjykatës dhe policë.
- Të ketë vazhdimësi, gjatë dhe pas Shërbimit të Provës. Të ngrihet një **Mekanizëm për mbikëqyrjen e të miturve** pas mbarimit të Shërbimit të Provës. Problematike mbetet stafi i pamjaftueshëm.
- Një tjetër problematikë që haset është edhe **mosha e përgjegjesisë penale**. Nuk ka shërbime specifike për fëmijët që janë nën moshën e përgjegjesisë penale por që bien në kontakt me veprën penale. Duhet të ekzistojë një qasje më sociale dhe jo t'i jepet përparësi ndëshkimit por sidomos edukimit.
- Sugjerohet ndërveprim për një **Plan Rehabilitimi për faktorët e rrezikut për të miturit**.
- **Dënimi Alternativ** duhet trajtuar si çështje juridiko-sociale. Nga viti 2009-2014 ka patur një rritje të dënimeve alternative: në 2012 (312), 2014 (412) , në 2015(2 muajt e parë) rezultojnë 84 të tilla.
- Nuk ka kërkesë nga ana e **Prokurorisë** për raporte të Shërbimit të Provës mbi rrethanat që çojnë të miturit në kryerjet e kundërvajtjeve apo veprave penale para se të arrijnë nëpër Gjykata. Fakt që nënkupton mungesë vëmendjeje nga ana e tyre për çështjet e të miturve, nënvlerësim të raporteve të përgatitura nga Shërbimi i Provës, apo dhe mungesë ekspertize të kualifikuar për t'i shqyrtuar këto raporte.
- Sugjerime për **Ndërhyrje në Legjislacion**: -Neni 46, Kodi Penal. Masat edukuese shihen si alternativë , ndërkohë që duhen vlerësuar para dhënies së

dënimit. Po ashtu, nuk parashikohen se cilat kritere do të merren parasysh në dhënien e masës së burgimit. Një sugjerim është që një ndër kriteret që duhet të parashikohet është interesi më i lartë i fëmijës, sic parashikohet dhe në legjislacionin në Kosovë.

-Në rastet e mundshme për përsëritje të kundërvajtjeve, duhet rikonsideruar kriteri i moshës minimale. Në vende të tjera ka dy sisteme të posaçme : Juvenile Justice dhe Children Justice. Gjithashtu për moshat 18-21 vjeç duhet të parashikohet mundësia për ti trajtuar si të mitur në raste të veçanta. Të shqyrtohen këto praktika të mira për të bërë ndryshime në legjislacion;
-Ekzistojnë vetëm dispozita të veçanta e jo një Kapitull i veçantë për të Miturit. Sugjerohet në legjislacion një harmonizim i këtyre dispozitave në një Kapitull të vetëm.

Pjesëmarrës në Sesionin I, Grupin e Punës: Institucione shtetërore dhe shoqëri civile:

Ministria e Drejtësisë-Idlir Peçi

Shërbimi i Provës-Deljana Nebiu

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve-Blerina Gjerazi

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve-Ina Verzivolli

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë(MMSR)-Ilsa Dede, Romina Liçaj

Komiteti Shqiptar i Helsinkit-Vjollca Meçaj, Bashkëkryetare e Grupit të Punës.

Save the Children-Elidjana Metani

Roma Active Albania-Adriatik Hasantari

Eksperte të Grupeve të Punës:Holta Ymeri, Aida Bushati

Atlantic Council of Albania-Fiorina Jaso

Universiteti i Tiranës- Fjoralba Caka, Erjona Bezatliu

Suela Hasani

Lorina Misku

Nirvana Deliu